



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-6647
Dt: 29.04.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika a dhe b të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datën 29.04.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. **shfuqizohet** vendimi me numër 01-112/02-4215 të datës 24.02.2023 për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave kundër vendimeve të inspektorëve të shërbimeve publike.
2. Shfuqizimi i vendimit si në pikën 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak se ndryshimeve të anëtarëve të komisionit.
3. Ky vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Të gjithë anëtarëve të komisionit
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Gjakovës
Opština Djakovica-Municipality of Gjakova



DATA/DATUM/DATE:	26.04.2024
REFERENC/	14/zyrtarisht/2024
PËR/ZA/TO:	z. Ardian Gjini-Kryetar i Komunes së Gjakovës
CC:	z. Samir Sylmeta, Udheheqes i Sektorit të Inspektoratit të Shërbimeve Publike
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Sektorit Ligjor, Komuna e Gjakovës
NGA/OD/FROM:	z. Hysni Muhadri, Drejtor i Drejtorisë për Inspektime, Gjakovë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë

I nderuar

Mbi bazë të kërkesës verbale të z. Samir Sylmeta-Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit të Shërbimeve Publike, kryesues i Komisionit për shqyrtim të ankesave kundër vendimeve të inspektorëve të shërbimeve publike, sipas Vendimit me numër 112/02-4215 të datës 24.02.2023, kërkon që të ndryshohet ky vendim me arsyetimin e bazuar se i mungon kualifikimi dhe përvoja në çështje juridike po ashtu puna e tij e vazhdueshme në teren e vështirëson punën edhe me angazhimin si kryesues i këtij komisioni.

Prandaj, duke u bazuar në nenin 75 (paragrafi 3) të Rregullores Nr.352/01-22518/2018 për Shërbimet Publike dhe Rendin Komunal, propozoj që komisioni ta ketë këtë përbërje:

1. Arta Sylta-Zyrtare Ligjore në Drejtorinë për Inspektime, kryesuese e komisionit;
2. Ilirjana Mamusha-Inspektore e Tregut, anetare e komisionit
3. Samir Sylmeta-Udhëheqes i Sektorit të Inspektoratit të Shërbimeve Publike-anetar i komisionit.

Bashkangjitur është Vendimi i cili propozohet të ndryshohet, numer 112/02-4215 i datës 24.02.2023.

Ju faleminderit për mirëkuptimin tuaj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 112/02-4191
Dt: 24.02.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 75 pika 3 të Rregullores Nr.352/01-22518/2018 për Shërbime Publike dhe Rend Komunal, duke vendosur lidhur me formimin e komisionit për shqyrtimin ankesave kundër vendimeve të inspektorëve të shërbimeve publike, me datë 24.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Formohet komisioni për shqyrtimin ankesave kundër vendimeve të inspektorëve të shërbimeve publike, në këtë përbërje:
 1. Samir Sylmeta – kryesues
 2. Ilirjana Mamusha – anëtare
 3. Arta Syla – anëtare
2. Komisioni i përshkruar si në pikën e parë të këtij vendimi, ka për detyrë dhe përgjegjësi që të ndërmer veprime konform dispozitave të Rregullorës Nr.352/01-22518/2018 për Shërbime Publike dhe Rend Komunal.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi me numër 01-112/02-4191 i datës 1802.2022.

Vendimi i'u dorëzohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Të gjithë anëtarëve të komisionit;
- Arkivit.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës së Gjakovës